

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr. 29469

29469

VENDIM
PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Në Tiranë sot me dt 08 Prill 2003 (dy mijë e tre), unë Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë M. Debi, pasi shqyrtova kërkesën e paraqitur nga MUSA KRAJA, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MËSONJËTORJA XXI e mesme "SH.P.K. ortak I së cilës është kërkuesi

KONSTATOVA:

Se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi MUSA KRAJA për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MËSONJËTORJA XXI e mesme "SH.P.K. me seli në Qytetin Tiranë ,në Rr" Irfan Tomini" Nr 41 ,Tiranë ,me administrator Musa Kraja ,me kohëzgjatje të zhvillimit të aktivitetit të saj mbi dhjetë vjet ,me objekt

Në fushën e arsimit privat :

Ushtrim veprimtarie arsimore në hallkën e arsimit të mesëm ,si dhe veprimtari arsimore kualifikuese ,botuese ,kurse verore , të gjuhëve të huaja .

Rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar

PËR KËTO ARSYE

Duke u mbështetur në nenet 2 dhe 5 të ligjit 7512 dt 10/08/1991 dhe ligji 7638 dt 19/11/1992 dhe 7667 dt.23.01.1993.

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MËSONJËTORJA XXI e mesme "SH.P.K. me ortak të vetëm dhe administrator të përgjithshëm Musa Kraja ,me seli në Qytetin Tiranë ,në Rr" Irfan Tomini" Nr 41 ,Tiranë ,me capital fillestar të themelimit 100.000 (njëqind mijë)lek ,me kohëzgjatje të veprimtarisë mbi dhjetë vjet ,me objekt :

Në fushën e arsimit privat :

Ushtrim veprimtarie arsimore në hallkën e arsimit të mesëm ,si dhe veprimtari arsimore kualifikuese ,botuese ,kurse verore , të gjuhëve të huaja .



AKT THEMELIMI

I shoqërisë “**MËSONJËTORJA XXI (e mesme)**” SH.P.K.

Sot më datë 24 Mars 2003 (dy-mijë-e-tre) Ortaku Themelues MUSA KRAJA i biri i Abdullait, i datëlindjes 03 Tetor 1938 lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, Rruga “Myslym Shyri”, Pallati 53, Ap 14 me letërnjoftimin UG 022427, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara nga ligjet Nr. 7512, dt. 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit”, Nr. 7638, dt.19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjit Nr 7667, dt.28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe format që duhen rrespektuar nga shoqëritë tregtare” kam marrë vendimin që të krijoj shoqërinë private me përgjegjësi të kufizuar “**MËSONJËTORJA XXL (e mesme)**” SH.P.K. me kushtet e mëposhme.

NENI 1

Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Tiranës në Rrugën “Irfan Tomini”, Nr 41. Ajo gëzon të drejtën për të hapur filiale, degë apo agjensi të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit

NENI 2

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet me normat juridike të këtij Akt Themelimi, Statutit të saj dhe Legjislacionit Shqiptar.

NENI 3

Kapitali themelor i shoqërisë është 100.000 (njëqind-mijë) lek që përbëhet nga kontributi i Ortakut Themelues i cili ka 100% të këtij kapitali.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është sa më poshtë vijon:

Në fushën e arsimit privat:

Ushtrim veprimtarie arsimore në hallkën e arsimit të mesëm si dhe veprimtari arsimore kualifikuese, botuese, kurse verore, të gjuheve të huaja.

Në raste të sigurimit të donatorëve ose të ndihmës të Fondacioneve të ndryshme, shoqëria mund të trajtojë edhe nxënës të varfër që kanë vështirësi shkollimi pa mbështetje ekonomike nga familja ose me mbështetje të kufizuar.

NENI 5

Afati i veprimtarisë do të jetë mbi dhjetë vjet duke filluar nga data e rregjistrimit. Ortaku mund të kërkojë prishjen e shoqërisë para përfundimit të afatit të mësipërm për arsye të përligjura.

NENI 6

Investimet dhe veprimtaria e shoqërisë gëzojnë mbrojtjen e shtetit, i cili krijon kushte të njëlloja me të gjithë subjektet e tjera private e shtetërore.
Shoqëria përballon detyrimet që krijon ndaj të treteve vetëm me kapitalet e saj.

Marrëdhëniet e punës

NENI 7

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontrates së punës. Për çështje që kjo kontratë nuk i parashikon, zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit Shqiptar në fuqi. Të gjithë të punësuarit në Shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga kjo shoqëri.

Organet drejtuese

NENI 8

Shoqëria tregtare "Mësonjëtorja XXI (e mesme)" sh.p.k. drejtohet nga administratori i vetëm i shoqërisë MUSA KRAJA, ky i fundit është edhe drejtor i shkollës për problemet shkencore-pedagogjike e organizative.

Bilanci dhe të ardhurat

NENI 9

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti përveç rasteve dhe urdhave të veçanta të Ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik humbje e fitime. Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës dhe pas pagimit të detyrimeve fiskale, pjesa tjetër i jepet në përdorim Ortakut të vetëm të saj.

NENI 10

Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme në rrugë trashigimie.

Shpërbërja e shoqërisë

NENI 11

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfardo shkak. Në rast të mbylljes së shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyren e likuidimit, cakton një ose shumë likuidatore duke i caktuar edhe detyrat përkatëse. Në rast likuidimi, emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet me shënimin "Shoqëri në likudim e sipër". Pasi bëhet njoftimi i mbylljes së

likuidimit dhe kryhen formalitet e duhura, Shoqëria me vendim të Gjykates, çregjistrohet nga regjistri tregëtar.

Dispozita të tjera

NENI 12

Ortaku i vetem detyrohet të ruajë sektorin e themelimit dhe të funksionimin e shoqërisë. Aktiviteti i shoqërisë do të përmbahet statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektojë dispozitat ligjore që janë në fuqi, si dhe ato që mund të dalin më vonë për ushtrimin e veprimtarisë private të shoqërive tregëtare

NENI 13

Ortaku i vetem nuk ndalohet të marre pjesë në shoqëri të tjera dhe në krijimin e çdo shoqërie tjeter individuale.

NENI 14

Ky akt themelim u hartua në mbështetje të Ligjit 7638 datë 09/11/1992 " Për Shoqëritë Tregëtare "dhe gjen mbështetje në gjithë Legjislacionin Shqiptar. Akt themelimi u hartua në kater kopje të barazvlefshme dhe hyne ne fuqi menjehere pas miratimit dhe regjistrimit te shoqërisë në regjistrin tregëtare.

ORTAKU I VETËM
MUSA KRAJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TIRANË

Nr 1062 Rep.



Nr 61 Kol.

VËRTE TIM

Sot me datë 24.Mars.2003 (dy-mijë e kater) ditën e hënë, në zyrën e Noterisë Tiranë me seli në Rrugën e "Duresit", para meje Noterit Publik Leonora Halili mu paraqit personalisht Musa Kraja, për identitetin e të cilit u sigurova nga leternjoftimi, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili deklaroi se këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë të përpiluar në mbështetje të Ligjit "Mbi Shoqëritë Tregëtare" e ka bërë me vullnet të lirë dhe të plotë dhe nënshkruan para Noterit Publik dhe unë Noterit e vërtetoj atë.



NOTERI PUBLIK
LEONORA HALILI
NOTERI PUBLIK
TIRANË TEL. 543 07



STATUT

i shoqërisë **“MËSONJËTORJA XXI (e mesme) SH.P.K.”**



I redaktuar sot më datë 24 Mars 2003 (dy-mijë-e-tre) me kërkesën e ortakut themelues:

Musa Kraja i biri i Abdullait, i datëlindjes 03 Tetor 1938, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, Rruga “Myslym Shyri”, Pallati 53, Ap 14 me leternjoftimin UG 022427, i cili në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara nga ligjet Nr. 7512, dt. 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit”, Nr. 7638, dt.19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjit Nr 7667, dt.28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe format që duhen rrespektuar nga shoqëritë tregtare”, ka vendosur që shoqëria e themeluar prej tij do të funksionojë në bazë të këtij statuti:

I - DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

NENI 1

Shoqëria **“Mësonjëtorja XXI (e mesme) SH.P.K.”** rregullon pozitën juridike, organet e saj, llojin e shoqërisë, kohën e veprimtarisë, marrëdhëniet e të punësuarve, etj në bazë të ligjit 7512, dt 10/08/1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavaruara dhe privatizimit”, ligjit 7638 dt 19/11/1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe ligjit 7667 dt 28/01/1993 “Për regjistrin tregtar dhe format që duhen rrespektuar nga shoqëritë tregtare”.

NENI 2

Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Tiranës në Rrugën “Irfan Tomini”, Nr 41 dhe kryen veprimtarinë e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të krijojë agjenci, degë e filiale të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj, duke rrespektuar ligjet e vendit në të cilin ato ngrihen.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është sa me poshte vijon:

Në fushën e arsimit privat:

Ushtrim veprimtarie arsimore në hallkën e arsimit të mesëm si dhe veprimtari arsimore kualifikuese, botuese, kurse verore, të gjuheve të huaja.


Në raste të sigurimit të donatorve ose të ndihmës të Fondacioneve të ndryshme, shoqëria mund të trajtojë edhe nxënës të varfër që kanë vështirësi shkollimi pa mbështetje ekonomike nga familja ose me mbështetje të kufizuar.

NENI 4

Shoqëria është person juridik shqiptar. Ajo do të paraqitet në qarkullimin civil me emrin **“MËSONJËTORJA XXI (e mesme) SH.P.K.”**

shkencore-pedagogjike e organizative. Ortaku i vetem ka të drejtë të caktojë si administratorë dhe persona tjerë të cilët nuk kanë cilësinë e ortakut.

- Administratori ka të drejtë të informohet për veprimtarinë e shoqërisë, të njihet me dokumentat e saj dhe llogaritë përkatëse, në rast se këto mbahen nga persona të tjerë të caktuar nga ortaku i vetem.
- Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ai mund të kryejë të gjithë veprimtaritë e administrimit në interes të shoqërisë.



III - KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 11

Veprimtaria dhe funksionimi i shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut dhe ndërtohet mbi parimin e llogarisë, duke u pasqyruar në bilancet e veta.

NENI 12

Kapitali fillestar i investuar nga ortaku themelues përbën bazën e krijimit të fondit themelor dhe mjeteve të xhiros.

NENI 13

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj financiare. Ajo disponon lirisht fondet e saj financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 14

Shoqëria mund të blejë pasuri të tjera, të cilat regjistrohen në emër të saj. Shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit të saj. Kur këto pjesë i nënshtrohen shitjes së detyruar, pengmarresi do të pranohet si person që i transferohet kapitali, përveç rastit kur shoqëria preferon të riblejë pjesët.

NENI 15

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të shoqërisë, të shprehur në lek ose në valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

NENI 16

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga administratori.

IV - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17

Handwritten signature or initials in the bottom left corner.

V - MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 20

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen sipas dispozitave të aktit të themelimit, statutit të shoqërisë si dhe të legjislacionit shqiptar të punës.

Punësimi në shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis shoqërisë dhe të punësuarit.

Mardhëniet midis shoqërisë dhe sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 21

Kontrata individuale e punës rregullon këto mardhënie:

- Marrja në punë, kushtet e të punësuarit për tu marrë në punë.
- Llojin e punës që do të kryejë i punësuarit, profesionet ndihmëse.
- Koha e punës ditore dhe javore, pushimi ditor dhe javor.
- Shpërblimi për kohën e punës, për punën jashtë kohës normale të punës, për punën natën e në ditët e pushimit e të festave zyrtare.
- Përgjegjësinë e palëve për mosrespektimin e kontratës.

NENI 22

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues të administratës janë përgjegjës ndaj shoqërisë për dëmet që i shkatojnë me faj dhe përgjigjen para saj civilisht.

VI - MBYLLJA E SHOQËRISË/LIKUIDIMI

NENI 23

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit të parashikuar në Aktin e Themelimit në këto raste:

- Kur shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë tre vjetëve të fundit rradhazi.
- Kur për këtë vendos Gjykata kompetente.

NENI 24

Kur vendoset shkrirja e shoqërisë, mbi propozimin e administratorit, Ortaku i Vetem cakton një ose më shumë likuidatorë, që realizojnë likuidimin e saj. Shoqëria gjatë likuidimit mban emërtimin dhe shënimin "Shoqëri në likuidim e sipër". Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 25

Ortaku i Vetem vendos mbi rregullshmërinë e likuidimit, për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuidatorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
KABINETI

Nr. 1721/16 Prot.

URDHËR

Nr. 211 datë 01.08.2001

PËR DHËNIEN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË
INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK


Në zbatim të Nenit 44 të Ligjit "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe të Neneve 6 e 7 të Ligjit Nr.8387 datë 30.07.1998 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.7952 datë 21.06.1995 - Për sistemin arsimor parauniversitar".

URDHËROJ:

1. Të miratoj lejen për funksionimin e institucionit arsimor jopublik të nivelit të arsimit të mesëm të përgjithshëm, me dhe pa ushqim, "Mësonjëtorja XXI", me administratore **znj. Nebije Kraja**, ortake e vetme e "Mësonjëtorja XXI" ShPK e rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë dhe me drejtues didaktik **z.Musa Kraja**.
Në këtë institucion që ndodhet në Rruga "Irfan Tomini" Vila Nr.41 Tiranë, do të punohet sipas strukturës së vitit shkollor, planit mësimor, programeve lëndore dhe teksteve mësimore e materialeve të tjera ndihmëse njëjloj si në shkollat e mesme të përgjithshme publike, veçse me shtesën:
a) Mësimi i gjuhës gjermane / spanjole / italiane / frënge si gjuhë fakultative me nga 2 orë / javë.
Në vitin shkollor 2001 - 2002 do të fillohet me klasën e parë.

2. Ngarkohet Drejtoria Arsimore e qytetit Tiranë të kontrollojë procesin mësimor dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën arsimore të këtij institucioni.

3. Ky udhër hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2001 - 2002.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
 DREJTORIA E ARSIMIT TË MESËM



Rruga e Durrësit, 23

Tiranë, më 01.08.2001


Nr. 1721 / 1b Prot.

Lënda : Dërgohet Urdhër miratimi për IAJP


Drejtorisë së shkollës mesme

“ MËSONJËTORJA XXI “

Rruga “ Irfan TOMINI “ Vila Nr.41



3



Bashkëlidhur u dërgojmë origjinalin e Urdhërit Nr.211 datë 01.08.2001 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës,

“Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”

U vëmë në dijeni se Drejtorisë Arsimore të qytetit Tiranë po i dërgojmë të njëjtin Urdhër miratimi dhe se pranë kësaj Drejtorie duhen paraqitur fotokopjet e dokumentave të depozituara në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Rexhep ÇUKO



DREJTOR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr 114 Rep

V E R T E T I M

Sot me date 31.mars.2003 (dy mij e tre) ditën e hënë, në Zyrën e Neterisë Tirane me seli në rrugë e Durrësit, para meje Noterit Publik Leonora HALILI u paraqit personalisht MUSA KRAJA i njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili depozitoi pranë kësaj Zyre shumën lek 100.000 (një qind mij) lek si kapital për krijimin e shoqërisë MESONJETORJA XXI e mesme sh.p.k.

DEPOZITUESI
MUSA KRAJA

Musa Kraja
[Signature]




NOTERI PUBLIK
LEONORA HALILI
NOTERI PUBLIK
TIRANE

[Handwritten signature]

KËRKESË

3 M. Dadi
06 03 2003



Kerkuesi: MUSA KRAJA ë bija ë Abdullait lindur në Shkoder me 03.tetor.1938 (një-mijë-e-nëntëqind-e-tidhjet e tete) dhe banuese në Tiranë në Rrugën e "Myslym Shyri", Pallati 53,ap 14.

29489

Objekti: Regjistrimin si person juridik per zhvillimin e aktivitetit privat të shoqërisë "MESONJETORJA XXI (e mesme)"SH.P.K. në bazë të ligjit 7512, Dt. 10/08/1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" dhe të ligjit 7638, Dt. 19/11/1992 " Për shoqëritë tregtare".

(5)

Përpara:

GJYKATËS SE RETHIT TIRANË

*Teq zyrtaritet
Jm Kërkesë
dt 08-03-03
Për tregtare
Dadi*

Në mbështetje të ligjit 7512, dt 10/08/1991 " Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" dhe të ligjit 7638, Dt. 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare", kam themeluar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "MESONJETORJA XXI (e mesme) " SH.P.K.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Ne fushen e arsimit privat:

Ushtirim veprimtarie arsimore ne hallken e arsimit te mesem,si dhe veprimtari arsimore kualifikuese,botuese,kurse verore,te gjuheve te huaja.
Ne rast te sigurimit te donatrove,ose te ndihmes se Fondacioneve te ndryshme,shoqeria mund te trajtoje edhe nexenes te varfer qe kane veshtirsi shkollimi pa mbeshteje ekonomike nga familja ose me mbeshteje te kufizuar.


Objekti i veprimtarisë së shoqërisë si dhe gjithë mënyra e funksionimit dhe administrimit të saj është rregulluar ne aktin e themelimit dhe statutin e kësaj shoqërie.
Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind-mijë) Lek dhe administrator i shoqërisë është MUSA KRAJA.

Prandaj ju lutem që në konformitet me ligjin të bëhet regjistrimi si person juridik i shoqërisë "MESONJETORJA XXI (e mesme)" SH.P.K.
Tiranë më 24 MARS 2003.

KËRKUES

MUSA KRAJA

Musa Kraja



Ürdüler registri mi

29469

2 a - "Mesajetorji XXI e mesme", Kyll

b - Di: "J. Bonini", Nr. 41. C. 1940

c - Ürdülerin. registri amminon, u' amminon
mesme, registri amminon mesme
Baterse, kurse u' kurse te jehere te
Luzje.

d. 100000 lile
C. Kurse Luzje

3. Adm: Kurse Luzje. dt. 1938. C. 1940
u. "Luzje" p. 53 / April C. 1940

4. ulei 10 yjet
M - 3 fletet
L - 6 fape

5. 24-03-03
28-03-03

[Signature]

Verretim. pu Kapitalin.
Nr. 1141. dt 31-03-03
NOTA. kurse fletet